

V E N D I M
Nr.60, datë 4.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Petrit Plloçi,	Anëtar i “““
Tefta Zaka,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Gjergj Sauli,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 4.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.73 Akti që i përket:

KËRKUES: MUHAMET BELA

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.31, përfaqësuar nga kryetari Korab Lita.
3. SHABAN MEMIA, përfaqësuar nga avokat Arben Ristani.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.949, datë 28.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.31.

BAZA LIGJORE:Nenet 131 e 141/1 të Kodit Zgjedhor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.949, datë 29.6.2001 ka shpallur fitues kandidatin për deputet zotit Shaban Memia, si dhe ka shpallur rezultatit e përqindjes së proporcionalit të subjekteve zgjedhore, duke lënë kështu në fuqi vendimin nr.25, datë 25.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.31.

Kandidati për deputet Muhamet Bela, si në kërkesën e paraqitur prej tij, ashtu dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes kërkoi pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.31 në të gjitha qendrat e saj të votimit, për shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Kërkuesi, duke iu referuar këtyre shkeljeve, pretendoi se: në 7 qendra është bërë votimi në lokale private; procesverbalet e qendrave të votimit janë plotësuar me të njëjtin shkrim dhe kanë një numër votuesish të ndryshëm në raport me listat; në katër qendra votimi procesverbalet janë pa nënshkrimin e sekretarëve të tyre; në tri qendra votimi kryetarët e komisioneve janë edhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; dy kuti të qendrave të votimit janë gjetur të hapura, kurse një kuti e mbyllur nuk i përket zonës 31; në qendrën e votimit nr.8 ka patur çrregullime në lista, presione në votime dhe se edhe në qendra të tjera janë vërtetuar shkelje të ndryshme të ligjit.

Në kundërshtim me pretendimet e mësipërme të kërkuesit, rezultoi se në 7 qendra votimi të caktuara në lokale private dhe konkretisht në ato me nr.2, 2/1, 5, 5/1, 6, 15 dhe 15/1 është lejuar të zhvillohet votimi për shkaqe objektive nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rreth këtij fakti dha shpjegimet e nevojshme përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe një veprim i tillë

konsiderohet i drejtë sepse ligjërisht bazohet në nenin 92 shkronja “a” të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendohet prej kërkuessit lidhur me plotësimin e procesverbaleve të qendrave të votimit etj., gjatë gjykimit rezultoi se procesverbalet e të gjitha qendrave të votimit që ka zona nr.31 janë firmosur pa përjashtim unanimsht nga anëtarët e Komisionit, të cilët nuk kanë bërë asnjë vërejtje ose kundërshtim për përmbajtjen e tyre. Ky fakt tregon për zhvillimin normal të procesit zgjedhor në të gjithë zonën dhe mbështetet edhe në dokumente të tjera të firmosura unanimsht edhe nga komisioni i zonës nr.31, siç janë tabela e deputetëve të listës shumemërore model 40/1, vendimi nr.25, datë 25.6.2001, etj.

Vetëm zëvendëskryetari i komisionit të zonës zgjedhore Shpëtim Kotarja ka firmosur me rezervë tabelën model 39/1, duke iu referuar protokollit të shkeljeve në zonën 31, mbajtur në datën 25.6.2001 prej përfaqësuesit të kandidatit Muhamet Bela. Në lidhje me këto shkelje, që përbëjnë në fakt objektin e kërkesës në shqyrtim, duhet thënë se ato jo vetëm që nuk u vërtetuan gjatë gjykimit të çështjes me provat e paraqitura prej kërkuessit, por shumica prej tyre, siç del nga renditja e mësipërme, nuk çmohen si të tilla prej gjykatës që të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve, ashtu siç kërkohet prej pikës 1 të nenit 113 të Kodit Zgjedhor.

Duke u nisur nga sa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga kërkuessi është e pabazuar dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.